Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratën të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
3595 02.10.2026
RAHOVEC - ORAHOVAC

Protokoli/Protokol/Protocol Nr.

Lëshuar nga/Pušteno od/Released from: **Përgaditur më/Pripremljenodana/Prepared at: 02-10-2026**

Për/Za/To : z.Smajl Latifi- Kryetar i Komunës së Rahovecit

Përmes/Preko/Over:

Nga/Od/From: Irfan Berisha, Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim

Lënda/Predmet/Subject

Raporti Nëntë mujor i punës, Janar - Shtator

Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive të saj, për periudhën janar–shtator 2026, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim ka realizuar detyrat dhe aktivitetet e parapara me Planin e Punës për vitin 2026. Drejtoria ka qenë e fokusuar në ofrimin e shërbimeve efikase, reagimin dhe përgjigjen në kohë ndaj kërkesave të qytetarëve, bashkëpunimin me institucionet dhe akterët relevantë për mbrojtjen e jetës dhe pronës, si dhe në sigurimin e një reagimi të shpejtë dhe profesional nga Njësia Profesionale e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit (NJPZSH).
Këto aktivitete dhe angazhime kanë kontribuar në realizimin e objektivave të planifikuara dhe përmbylljen me sukses të punës për periudhën nëntëmujore janar–shtator 2026.

Gjatë periudhës Janar-Shtator 2026, sipas planit janë realizuar këto aktivitete:

- Në komunën e Rahovecit në muajin janar, përkatësishtë me datë 5, 6 dhe 7 Janar, si pasoj e reshjeve të shumta dhe pa ndërprer të shiut, janë shkaktuar vershime në pjesë të ndryshme të komunës së Rahovecit, zonat më të prekura nga vërshimet kanë qenë; Fortesa, Xërxja, Ratkoci, Qifllaku, Malsia e Vogel, Gexhë, Dibidol, Krushë e Madhe etj. Dëmet janë shkaktuar në ekonomitë familjare, Bujqesi, Biznese, infrastrukturën Publik dhe Private.

- Pasë vlersimit të dëmëve dhe përpilimit të Raportëve nga Komisioni për vlersim të dëmeve për vitin 2025 dhe për vershimet e dative 5,6 dhe 7 janar 2026, të dy raportët, së bashku me lëndët përkatëse janë dorzuar në komisionin qendëror për vlersim dhe kompenzim të dëmeve.

- Sipas Planit Vjetor të Punës, janë inspektuar dhe vlerësuar lumenjtë, përrenjtë dhe kanalet e hapura në territorin e Komunës së Rahovecit. Ky inspektim është realizuar me qëllim të uljes së rrezikut nga fatkeqësitë natyrore, përkatësisht nga vërshimet.

- Pas vlerësimit të gjendjes në terren të lumenjve, përrenjve dhe kanaleve të hapura, është përpiluar raporti me të gjeturat në terren. Raporti u është përcjellë **Drejtorisë për Shërbime Publike, Drejtorisë për Urbanizëm dhe Drejtorisë për Bujqësi**, për ndërmarrjen e masave për sanimin dhe përmirësimin e gjendjes në terren, me qëllim të uljes së rrezikut nga vërshimet.

- Gjatë muajit **mars 2026**, është kryer servisimi i rregullt i **katër automjeteve të Njësisë së Zjarrfikësve**. Gjithashtu, është kryer **riparimi teknik i një automjeti të Zjarrfikësve dhe i një**

pompe uji, me qëllim të sigurimit të gatishmërisë teknike dhe funksionalitetit të pajisjeve për intervenim në raste emergjente.

- Me datë 07 mars 2026, rrethe ores 1500L është raportuar i humbur Alush (vesel) Kastrati nga Fshati Zatriq, nga data 08 deri 12.03.2026, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpetim ka qenë e angazhuar në operacionin e kërkimit të përsonit të humbur, në këtë operacion kanë qenë të angazhuar edhe njesia e Zjarrëfiksëve, ekipet mjekësore nga QKMF-së, Policia e Kosovës, FSK si dhe Shoqata e Kërkim Shpëtimit të Kosovës, pas gjetjes së trupit të pajetë me 12 mars 2026, operacion i kërkimit është përmbyll.

- Më 30 prill është realizuar një ushtrim në tavolinë, me fokus në koordinimin ndërinstitucional dhe identifikimin e kapaciteteve komunale për menaxhimin e fatkeqësive natyrore. Ushtrimi u zhvillua në bashkëpunim me Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe ekipin amerikan për Çështje Civile.

- Më 4 maj 2026 është shënuar Dita Ndërkombëtare e Zjarrfikësve, me ç'rast janë zhvilluar aktivitete të ndryshme, ndër të cilat ushtrim për reagim të shpejtë nga Njësia e Zjarrfikësve, si dhe aktivitete për vetëdijesimin e qytetarëve mbi rëndësinë e krijimit të kushteve për intervenim sa më të shpejtë në rast zjarri. Gjithashtu, qytetarëve u janë shpërndarë broshura dhe materiale informuese për rreziqet nga zjarret, masat parandaluese dhe rëndësinë e raportimit sa më të hershëm të rasteve të zjarrit. Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Zjarrfikësve, Kryetari i Komunës, z. Smajl Latifi, ka ndarë mirënjohje për disa zjarrfikës, në shenjë vlerësimi për kontributin dhe angazhimin e tyre në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive profesionale.

- Në kuadër të Planit të Punës, janë organizuar ligjërata dhe aktivitete vetëdijesuese në institucionet arsimore, me qëllim të informimit dhe ngritjes së vetëdijes së nxënësve lidhur me rreziqet nga zjarret, masat parandaluese, mënyrat e mbrojtjes dhe veprimet që duhet të ndërmerren në rast të paraqitjes së zjarrit. Gjithashtu, nxënësve u janë shpërndarë materiale informuese dhe edukative, me qëllim të forcimit të njohurive dhe promovimit të kulturës së parandalimit dhe reagimit të hershëm ndaj zjarreve.

- Gjatë muajve maj dhe qershor është ndërmarrë një fushatë vetëdijesimi për mbrojtjen nga zjarret dhe raportimin e tyre gjatë sezonit veror. Janë shpërndarë apele dhe materiale informuese në lokalitete të ndryshme, si dhe janë realizuar aktivitete informuese përmes rrjeteve sociale, me qëllim të ngritjes së vetëdijes së qytetarëve për parandalimin dhe raportimin e rasteve të zjarreve në kohë. Fushata e vetëdijesimit ka vazhduar edhe gjatë muajve korrik dhe gusht, me synim informimin dhe sensibilizimin e mëtejshëm të qytetarëve për rreziqet nga zjarret dhe rëndësinë e raportimit të tyre në kohë.

- Gjatë muajit qershor në fshatin Fortesë, në kuadër të masave për parandalimin dhe zvogëlimin e rrezikut nga vërshimet, është realizuar pastrimi i një pjese të shtratit të lumit Bellaja, me qëllim të përmirësimit të rrjedhës së ujit dhe uljes së rrezikut nga përmbytjet në atë zonë. (Punimet janë realizuar nga operatori ekonomik i kontraktuar nga Drejtoria e Bujqësisë).

- Në muajin qershor përkatësisht me datën 18 Qershor 2026, në bashkëpunim me Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME) me mbështetjen nga OSCE, është mbajtur një punëtori për menaxhimin e fatkeqësive natyrore në Komuna e Rahovecit. Punëtoria është zhvilluar sipas një skenari specifik për menaxhimin e vërshimeve në Komunën e Rahovecit, me fokus forcimin e kapaciteteve institucionale dhe koordinimin ndërinstitucional në rast të emergjencave natyrore.

- Më datë 10 korrik 2026 është mbajtur konsultimi publik për Planin Operativ Emergjent Lokal (POEL), me qëllim të prezantimit të planit, marrjes së komenteve dhe propozimeve nga pjesëmarrësit, si dhe përfshirjes së tyre në procesin e finalizimit të dokumentit.

- Me 14 Korrik 2026 kamë marr pjesë në takimin për themelimin e Kolegjiumit për Siguri dhe Emergjenca, i cili është organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës.

- Më datë 21 korrik 2026, rreth orës 16:20, Komuna e Rahovecit u përfshi nga një stuhi e fuqishme e shoqëruar me erëra të forta, e cila preku pothuajse të gjithë territorin e komunës së Rahovecit, në këtë raste janë shkaktuar dëme në Bujqësi në Ekonomi Familjare dhe në Biznese, dëmet kanë qenë në qati të objekteve të ndryshme, vreshta, sera, pemë, rrjet elektrik etj.

- Më datë 27 korrik 2026, në orët e hershme të mëngjesit, Komuna e Rahovecit u përfshi nga të reshurat intensive dhe të pa ndërprera, këto të reshura preken pothuajse të gjithë territorin e komunës së Rahovecit, në këtë raste janë shkaktuar, vërshime në qytet dhe ne disa pjesë tjera të komunës së Rahovecit, si pasoj e këtyre reshjeve janë shkaktuar dëme në Bujqësi në Ekonomi Familjare dhe në Biznese.

- Gjatë muajit Gushtë, në kuadër të masave për parandalimin dhe zvogëlimin e rrezikut nga vërshimet, është realizuar pastrimi i një pjese të shtratit të përroit në mes të fshatit Krushë e Madhe dhe Celinë, me qëllim të përmirësimit të rrjedhës së ujit dhe uljes së rrezikut nga përmbytjet në atë zonë. (Punimet janë realizuar nga operatori ekonomik i kontraktuar nga Drejtoria e Bujqësisë).

- Gjatë muajit Gushtë, sipas kërkesave të pranuara, kemi mbështetur me ekipe të zjarrfikësve, më datë 2 dhe 3 gushtë festivalin "Fardi Fest" si dhe më datë 7,8 dhe 9 gushtë festivalin "Chillifest", me qëllim garantimin e sigurisë dhe reagimit të shpejtë në rast nevoje.

- Më datat 28 dhe 29 gusht, zyrtari për emergjenca i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim ka marrë pjesë në një punëtori të organizuar nga AME. Qëllimi i kësaj punëtorie ka qenë shkëmbimi i përvojave dhe diskutimi i çështjeve me rëndësi në fushën e menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë, parashikimit të bazuar në ndikim, si dhe sistemeve të paralajmërimit të hershëm.

- Gjatë muajit Shtator, sipas kërkesave të pranuara, kemi mbështetur me ekipe të zjarrfikësve, me datë 4,5 dhe 6 shtator festivalin "Hardh Fest" me qëllim garantimin e sigurisë dhe reagimit të shpejtë në rast nevoje.

- Gjatë muajit shtator në fshatin Fortesë, në kuadër të masave për parandalimin dhe zvogëlimin e rrezikut nga vërshimet, është realizuar pastrimi i shtratit të përroit që lidhet me lumit Bellaja, me qëllim të përmirësimit të rrjedhës së ujit dhe uljes së rrezikut nga përmbytjet në atë zonë. (Punimet janë realizuar nga operatori ekonomik i kontraktuar nga Drejtoria e Bujqësisë).

- Gjatë muajve gusht, shtator dhe tetor 2026, në të gjitha institucionet komunale është realizuar servisimi dhe mbushja e aparateve të zjarrfikjes, nga kompania "NPSH Emergjenca", me qëllim të sigurimit të funksionalitetit dhe gatishmërisë së tyre për përdorim në rast zjarri.

- Gjatë muajit shtator 2026, është finalizuar dhe miratuar Plani Operativ Emergjent Lokal (POEL) për Komunën e Rahovecit. Pas miratimit, POEL-i është publikuar në faqen zyrtare të Komunës së **Rahovecit** dhe është shpërndarë në institucionet përkatëse, me qëllim të informimit dhe zbatimit të tij nga strukturat përgjegjëse.

- Sipas kërkesës së Stacionit Policor në Rahovec, është ofruar mbështetje me një ekip të Zjarrfikësve gjatë zhvillimit të ndeshjes së basketbollit në Sallën e Sporteve "Mizahir Isma", me qëllim të garantimit të sigurisë dhe reagimit të shpejtë në rast nevoje.
- Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar edhe aktivitete të ndryshme të përditshme, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Gjatë periudhës **janar–shtator 2026**, Ekipi i Zjarrfikësve ka pranuar gjithsej **293 kërkesa për intervenim.**

Sipas natyrës së intervenimeve, kërkesat janë evidentuar si më poshtë:

- **165** intervenime në raste zjarri;
- **11** intervenime në aksidente rrugore;
- **11** intervenime në raste vërshimesh;
- **60** intervenime teknike; dhe
- **46** raste të shërbimeve të tjera.

Nga të gjitha kërkesat e pranuara, gjatë kësaj periudhe janë realizuar gjithsej **293 intervenime**, të klasifikuara sipas kategorive të sipërpërmendura.

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe intëvenimet tjera janar-shtator 2025														
2026	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i Teknike	Nr.i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Thirrje të rrejshme	Të lënduar			Të vdekur			Gjithsejt
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot	
Janar	44	8	21	3	1	11	0	0	0	0	0	0	0	44
Shkurt	12	7	1	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	12
Mars	33	20	4	8	1	0	0	0	0	0	0	0	0	33
Prill	16	8	0	7	1	0	0	0	0	0	0	0	0	16
Maj	21	4	3	9	5	0	0	0	1	1	0	0	0	23
Qershor	17	12	4	1	0	0	1	0	0	0	0	0	0	18
Korrik	41	20	17	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	41
Gusht	59	46	6	6	1	0	0	0	0	0	0	0	0	59
Shtator	50	40	4	4	2	0	0	0	0	0	0	0	0	50
Gjithsejt	293	165	60	46	11	11	1		1	1				296

Irfan Berisha
Drejtor i DMSH